



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQERIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Datë \_\_\_/12/2022

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**LËNDA: PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**SHERBIMI I PRINTIMIT DHE ZARFIMIT TË FATURAVE PËR NEVOJAT E SHRUKD**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**PRINTIME DHE SHERBIME TE LIDHURA / 79800000-2**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 24.445.440,00 (Njëzet e katër milion e katërqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e dyzet) **Monedha, pa TVSH**

*Argumentimi i fondit limit : Perllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKD ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë.

Në parashikimin e numrit të faturave për një periudhë dy vjeçare nga momenti i lidhjes së kontratës janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Kontratat e reja
- Pasivizimet
- Aktivizimet

Dukë parë ecurinë e faturave të printuara në vitin 2021- 2022 si dhe agregimit të shoqërive të ujësjellësave Krujë, Kavajë, Rrogozhinë vihet re një levizje e përmuajshme jo e njëtrajtshme e numrit të faturave.

1. Sipas parashikimit numri i faturave për periudhën 2 (dy) vjeçare është **3,840,000** (tre milion e tetëqind e dyzet mijë) fatura për tu printuar. Në këtë numër përfshihen :
  - ✓ Të gjitha faturat mujore progresivisht në rritje si rezultat i rritjes së kontratave
  - ✓ Te gjitha faturat e kontratave te aktivizuara.
  - ✓ Parashikimi në vonesa të lidhjes së kontratës në vazhdimësi si rezultat i ankesave të mundshme gjatë procedurave të prokurimit.

Lista e shërbimeve

Nr	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia
1	Printimi dhe zarfimi i faturave për nevojat e SHRUKD	copë	3,840,000

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 9;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 3

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit 2.2

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si dhe në nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure. . *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”,* si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2 .** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40%** të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- ISO 27001 ose ekuivalente (standardi i sigurisë së informacionit),
- ISO 9001:2015 ose ekuivalente (standardi i menaxhimit të cilësisë)

Objekti i të cilave duhet të perputhet me objektin e kësaj procedure prokurimi, certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Si dhe bazuar në nenin të 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Vendosja e certifikatës së kërkuar më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

Vendosja e ISO 9001 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave dhe siguron qëndrueshmërinë e mallit që furnizohet, pra ky standard mundëson menaxhimin e cilësisë dhe vlerësimin e konformitetit si edhe menaxhimin e mjedisit, duke siguruar kështu që produktet të jenë të sigurta, të besueshme dhe të cilësisë së mirë.

Duke qenë se faturat përmbajnë të dhëna sensitive të klienteve këto duhet të jenë të garantuara dhe të siguruara me standardin ISO 27001. ISO 27001 detajon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS) – qëllimi i të cilit është të ndihmojë organizatat t'i bëjnë më të sigurta asetet e informacionit që ata mbajnë.

Pikërisht paraqitja e këtyre ISO tregon se, OE zbatojnë sistemet e menaxhimit në përputhje me këto standarde dhe rrit performancën dhe besueshmërinë për cilësinë dhe garancinë e mallrave që

do të furnizohen nga operatori ekonomik fitues. ISO duhet të jenë në emër të shoqërive dhe në objektet e këtyre çertifikatave duhet të jetë përfshirë objekti i prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura me sistem kamerash për magazinim dhe prodhim, të siguruara me kamera sigurie.

Për plotesimin e këtij kriteri OE duhet të paraqesë çertifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar të vlefshme gjithë periudhën e kontratës **dhe foto të ambientit.**

**Argumentim:** Duke qene se faturat permbajne te dhena sensitive te klienteve keto duhet te jene te garantura dhe te siguruara me nje sistem kamerash per te kontrolluar personat te cilet kane akses gjate te gjithë procesit te printim zarfim dhe magazinimit

2.3.4 Operatori ekonomik për amientet ku do të kryhet procesi i punës duhet të disponojë sistem kamerash dhe access kontroll.

Kjo të vërtetohet me anë të një vetëdeklarimi nga Operatori Ekonomik ne te cilen shprehet se objekti eshte i mbikqyrur nga kamerat e sigurise CCTV dhe se disponon akses kontroll.

**Argumentim:** Bazuar në ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 për mbrojtjen e të dhënave personale , Ndryshuar me Ligjin, Nr. 48/2012, F.Z. 53, Ndryshuar me Ligjin,Nr.120/2014, F.Z 160, I përditësuar, duke qene se faturat permbajne te dhena sensitive te klienteve keto duhet te jene te garantura dhe te siguruara me nje sistem kamerash.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë sistem serverash për perpunimin e të dhënave, në ambjent të mbyllur të survejuar me kamera dhe të ndarë nga ambjente të tjera. Kjo vërtetohet me anë të një vetëdeklarimi nga Operatori Ekonomik.

**Argumentim:** Bazuar në ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 për mbrojtjen e të dhënave personale , Ndryshuar me Ligjin, Nr. 48/2012, F.Z. 53, Ndryshuar me Ligjin,Nr.120/2014, F.Z 160, I përditësuar, Duke qene se faturat permbajne te dhena sensitive te klienteve keto duhet te jene te garantura dhe te siguruara me nje sistem serverash për perpunimin e të dhënave në ambjent të mbyllur të survejuar me kamera dhe të ndarë nga ambjente të tjera per te kontrolluar personat te cilet kane akses gjate te gjithë procesit te printim zarfimit

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë një soft menaxhimi dhe monitorimi të punës (printimit dhe zarfimit te faturave) e QR kodi në kohë reale.

Për të provuar disponimin e ketij softi duhet të paraqesë liçensën e software-it ose autorizim prodhuesi të softit ose distributorit.

**Argumentim:** Per te perballuar dhe kontrolluar sasine e madhe te printimit te gjitha faturave mujore brenda afateve te nevojshme dhe duke qene se faturat permbajne te dhena sensitive te klienteve keto duhet te jene te siguruara me nje soft menaxhimi dhe monitorimi të punës (printimit dhe zarfimit te faturave) në kohë reale

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 10 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Punonjesit duhet të figurojnë në listpagestat e 6 (gjashtë) muajve të fundit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Marrja dhe perpunimi i te dhenave sipas software qe eshte kerkuar, pas perpunimit te gjithe ketyre te dhenave behet kalimi i tyre per shtyp. Te cilat nga keto 2 procese kerkojne jo me pak se **3 punonjes**, Ku njeri do jete ne perpunimin e te dhenave dhe 2 do të jenë makinistet e makinerise qe do te printohj faturat. Mbasi behet procesi I printimit, kryhet zarfimi (selfmail), I cili kerkon **3 punonjes**, ku njeri eshte ne mbushjen e makinerise me letra te printuara, dhe 2 ne fund te makinerise qe bejne ndarjen sipas gabinave. Pas procesit te zarfimit eshte procesi i formimit te kutive dhe vendosja e etiketave sipas zonave dhe fshatrave, ku duhen te pakten **2 punonjes**. Mbas ketij procesi eshte procesi tjetër i mbylljes se kutive dhe dhe ngarkimit te tyre ne automjetet e firmes, dorezimin dhe marrjen fatures, i cili është dhe personi pergjegjes qe ben numerimin dhe dorezimin e tyre ne magazinat e UKD sha (ku perpilon dhe procesverbalin e marrjes ne dorezim). Se bashku me shoferin dhe personin pergjegjes behet nje total prej **10 punonjesish**.

**Shenim: I gjithë ky proces duhet të kryhet brenda 72 oreve nga momenti I marrjes se materialit, per arsye se cdo konsumatori duhet ti shkoj fatura ne objekt. Personat qe do te marrin pjese ne kete proces do te percaktohen me nje procesverbal te mbajtur nga te dyja palet. Ne procesin e printim zarfimit ka redesi shume te madhe cilesia e shtypit dhe dhe zarfimit, koha e realizimit si dhe me e rendesishmja eshte mos shperndarja e informacionit qe permbajne keto fatura.**

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 3 (tre) makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo formë tjetër disponimi që njih Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes, ose cdo formë tjetër disponimi që njih Kodi Civil i RSH
- Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitetjo me pak se prej jo më pak se 1041 fletë A4/ore të printuara nga te dyja anët.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti), për të përballuar sasinë e madhe të printimit të gjitha faturave mujore brenda afateve të nevojshme .

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në dst, në datën dhe orën e caktuar si afat i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, ato janë përzgjedhur për artikujt që kanë sasi të konsiderueshme të cilët janë më të kërkuarit.

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.



## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

Printimi i faturës dhe palosje në versionin “Selfmailer”

Formati: A4

Letra: LaserBond 90gsm

Fatura duhet të zarfohet në formën “selfmailer” me perforim dhe të paloset në formën “C”

Ngjyra:

Letra e paraprintuar (Logo kryesore në të dyja krahët e faturës si dhe reklama në pjesën e mbrapme) të jetë me ngjyra dhe të dhënat e tjera. Imazhi i letrës mund të ndryshojë çdo tre (3) muaj.

Gjithashtu shumat debitore dhe teksti që e shoqëron si dhe fjala “Debitor” duhet të jetë me ngjyrë të kuqe (për klientët debitorë).

Të dhënat e tjera të faturës me ngjyrë të zezë.

Fatura duhet të ketë dy linja perforimi përgjatë gjatësisë së faturës për hapjen e zarfit si edhe instruksionet përkatëse për hapjen e zarfit. Ngjitje nga krahët anësore. Perforim horizontal tek linja e treguar. Cdo faturë, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë numrin serial të lotit të fileve, zonën dhe numeratorin për zonë.

Bashkëngjitur edhe një simulim se si duhet fatura (debitore).

### SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

UKD do të dergojë filen për imazhin e letrës së parashtypur 30 ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit. Ky imazh mund të ndryshojë çdo muaj.

Brenda 2 ditësh nga momenti i marrjes së këtyre të dhenave operatori duhet të përfundojë shërbimin e printimit dhe zarfimit.

Afati është 24 muaj nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

# PJESA PERPARA

KONSTRUKTORI

TITULLI I SHËRBIMIT

**UKDURRËS**

RAJONIN Durrës

RAJONIN Durrës

KODI: 17.030.001

**UKDURRËS**

**UKDURRËS**

RAJONIN Durrës

RAJONIN Durrës

KODI: 17.030.001

Titulli i Shërbimit: **UKDURRËS**

Kodi: **17.030.001**

PJESA MBRAPA

FATURË TATIMORE Shtator 2022

Qendra Kenete xxxxxxxxxxxx		Nr. i faktures: xxxxxxxxxxxx		
Qarku Dures		Data e faktures: xxxxxxxx		
Rrethi Dures		Nr. i kontrates: xxxxxxxx		
28 KENETE / 2889 / 21		Plani Tarifor: Sipas makat Institucion te Kanalozime		
Nr. MATESE	Nr. VILES	LEXIM I MUJIT	LEXIM I MËPARSHËM	KORSUM I MUJIT
xxxxxxx	xxxxx	260.00	258.00	x
Afrore:		0.00	Total me Mates:	2.00
Total:				2.00

PËRSHKIMI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA PA TVSH	TVSH	VLERA
Uje i peshem	m3	2.00	120.00	240.00	48.00	288.00
Kanalozime (Largimi & Përpunimi uj	m3	2.00	60.00	120.00	24.00	144.00
Tarifa Shërbimi (Tarifa shërbimi)	Njesi	1.00	150.00	150.00	30.00	180.00
<b>SHËRBIME TË TJERA</b>						
Fidatesa dhe Rakordime	-	-	-	0.00	0.00	0.00
Te Tjera	-	-	-	0.00	0.00	0.00
Rakordim Teknik i Vleres	m3	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
VLERA E FATURUAR NGA UKD				510.00	102.00	612.00
<b>TARIFAT DHE TAKSAT BASHKIAKE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI</b>	<b>VLERA PA TVSH</b>	<b>TVSH</b>	<b>VLERA</b>
Tarifa Hërkomi	Njesi	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Tarifa e Çelbimit	Njesi	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Tarifa e Pasimit	Njesi	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Taksa Hërkose	m2	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Takse mbi Truallin	Njesi	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Kost i aktmarrveshtjes						0.00
<b>VLERA TOTALE PER TU PAGUAR</b>						<b>612.00</b>

Njoftim i ndërsuar abonentit, detyrimi juaj ne principal eshte -xxx LEK, kamafionese xxx LEK  
**PAGESA** - Faturo e konsumit te ujit te peshem eshte Titull Ekzekutiv ne baze te Ligjit Nr.8975, date 21.11.2002.  
**ANKIMIMI** - Ne rast se konsumatori nuk eshte dakort me sesione e ujit qe i eshte faktuar duhet te paraqese ankese

Pagesa duhet kryer brenda dates 11-11-2022

**Kujdes:** Per te bere pagesen duhet te paraqiteni me kete **1071921**

KONTRAKTUESI: xxxxxxxxxxxxxxxx

Qarku Dures

NIP: xxi78316-xc1c-43c-943-3e37892f81

SEL: F984D9C10C3F689C8C486788C79C2Rrethi Dures

Bashkia Dures

**QR CODE**

<b>NR. I FATURES:</b>	xxxxxxxxxxxxxxxxxx
<b>Vlera perfshire TVSH:</b>	612.00
<b>Taksa dhe tarifa vendore</b>	0.00
<b>Vlera perfshire AKM:</b>	612.00
<b>SHUMA PER T'U PAGUAR</b>	612.00

Faturen tuaj mund ta printoni ne faqen e internetit seifcare.ukdures.al

